

Tax Alert Kosovo

Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore

The Law on the Administration of Tax Procedures



PwC Kosovo - Tax Alert

Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore

Më 28 Janar 2024 ka hyrë në fuqi Ligji për administrimin e procedurave tatimore i cili ka për qëllim rregullimin e procedurave për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës që janë në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të ATK. Përmes këtij ligji synohet të sigurohet një kornizë gjithëpërfshirëse për rregullat dhe procedurat tatimore në Kosovë, duke u përshtatur me zhvillimet e fundit në fushën e tatimeve dhe mjetet moderne të komunikimit të cilat së bashku shpien tek një sistem tatimor më të avancuar.

Pikat kryesore të ndryshimeve nga ligji paraprak janë përmbledhur si në vijim:

Ndryshimet	Ligji paraprak	Ligji aktual
Përkufizimi i pronarit përfitues	Pronari përfitues është konsideruar të jetë individ apo etniteti juridik i cili gëzon përfitimet nga një aset në pronësi si dhe i cili ka dominim dhe kontroll mbi një aset.	Me ndryshimet në ligj është shtuar rasti tek personi fizik, kur ushtrohet kontrolli efektiv dhe në rastin e personave juridik është vendosur pragu prej 25 % i interesit në pronësi. Përveç kësaj janë shtuar rastet specifike për pronar përfitues si marrëveshjet ligjore, fondacionet, trustet, sigurimet e jetës dhe sigurimet e investimeve të ndërlidhura me biznes.
Zgjerimi i listës së personave të lidhur	Personat e lidhur janë konsideruar të jenë: personat që janë zyrtarë apo drejtorë të biznesit të njëri-tjetrit, ortakë në biznes, punëdhënës - i punësuar, kur kontrollojnë 50% apo më tepër të aksioneve apo të drejtave të votimit, personi që drejtpërdrejt apo tërthorazi kontrollojnë personin tjetër, dy personat drejtpërdrejt apo tërthorazi janë të kontrolluar nga një person i tretë, personat janë bashkëshort, të afërm të brezit të tretë, të brezit të dytë të bashkëshortit apo bashkëshortes.	Si shtesë nga ligji paraprak, në listën e personave të lidhur është shtuar, edhe rasti se person i lidhur konsiderohet të jetë secila kompani mëmë, degë dhe nëndegë që janë pjesë e grupit shumëkombësh.
Zgjerimi i kriterëve për rezidencë	Rezidenca është përcaktuar aty ku ka qenë vendbanimi, ose prezenca prej 183 ditë; ose vendi i themelimit ose vendi i menaxhimit efektiv.	Personi fizik konsiderohet të jetë rezident kur vendbanimin kryesor ka në Kosovë; ose kur kalon më shumë se 183 ditë në Kosovë; ose ka qendrën e interesave jetike në Kosovë. Ndërsa për persona juridik, është hequr kriteri i themelimit dhe tani është vetëm vendi efektiv i menaxhimit.
Zgjerimi i kuptimit të vlerës së hapur të tregut	Vlera e hapur e tregut është përcaktuar të jetë çmimi që përcaktohet për mallra/shërbime të ngjashme për një transaksion tregtar të paanashëm.	Me ligjin e ri është shtuar rasti kur nuk mund të përcaktohet vlera e hapur e tregut, ku në lidhje me mallra/shërbime vlera e hapur e tregut do jetë çmimi jo më i vogël se çmimi blerës ose çmimi i kostos në kohën furnizimit.
Shkurtimi i ditëve për çregjistrim të tatimpaguesit	Më herët numri i ditëve për shqyrtimin e kërkesës për çregjistrim nga ATK ishte 60 ditë.	Tani numri i ditëve është shkurtuar, i cili është 45 ditë.
Rregulla e re në lidhje me mbajtjen e regjistrave	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak	Në ligjin e ri është shtuar rregulla që i jap të drejtë ATK të përcaktojë formatin e mbajtjes së regjistrave si dhe kriteret që duhet t'i përmbajnë softverët që përdorin bizneset për shitjet me shumicë dhe pakicë.

Ndryshimet	Ligji paraprak	Ligji aktual
Rregulla e re në ruajtjen e regjistrave nga tatimpaguesit	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak	Në ligjin e ri është përfshirë dispozita e re në lidhje me kohën që duhet të ruhen regjistrat për kategori të caktuara si për: - Pasuritë që janë të zhvlerësueshme për më shumë se 6 vite duhet të mbahen për jetëgjatësinë e zhvlerësueshme të pasurive, plus 1 vit shtesë - regjistrat e lidhura me fitimet kapitale duhet të mbahen derisa pasuritë e tilla të jenë shitur apo ekspozuar me plus 6 vite shtesë - regjistrat që lidhen me kontratat afatgjate të ndërtimit, duhet të ruhen me plus 6 vite nga përfundimi i projektit - regjistrat që lidhen me shërbimet elektronike duhet të mbahen për një periudhë prej së paku 10 vite pas përfundimit të periudhës tatimore kur janë ofruar shërbimet elektronike - regjistrat që lidhen me transaksionet e arit të investueshëm duhet të mbahen për një periudhë prej së paku 10 vite.
Zvogëlimi i shumës së transaksioneve B2B	Shuma e transaksioneve B2B e cila është paguar në kesh ishte 500 EUR.	Shuma e transaksioneve B2B e cila paguhet në kesh është zvogëluar në 300 EUR, ndërsa për transaksionet B2C shuma mbetet të cakohet nga Ministria e Financave.
Rregulla të reja për punëdhënësit lidhur me punëtorë	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak	Në ligjin e ri është përfshirë dispozitë e re e cila obligon që çdo pagë që i paguhet të punësuarit të bëhet përmes një institucioni financiar të licencuar. Gjithashtu është shtuar dispozita e cila obligon çdo punëdhënësit të informojë ATK për lidhjen e një kontrate të punës, një ditë para fillimit të punës së punëtorit.
Ndarja e të dhënave nga bankat komerciale dhe noterët	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak	Tani bankat komerciale dhe noterët janë të obliguar që në baza mujore, tremujore ose me kërkesë, të dorëzojnë në ATK të dhënat për transaksionet vendore dhe ndërkombëtare të personave fizik dhe personave juridik.
Zvogëlimi i periudhës për korrigjim të deklarimit tatimor	Periudha për të cilën tatimpaguesi ka mundur të kthehet mbrapa për të korrigjuar deklarimin tatimor ka qenë 6 vite.	Tani me ligjin e ri kjo periudhë është zvogëluar në 3 vite.
Kufizimi i kohës së kalkulimit të interesit për mos përmbushje të obligimeve	Në ligjin paraprak kalkulimi mujor i interesit ka vazhduar deri në datën kur tatimi është paguar.	Sipas ligjit të ri, është kufizuar koha e kalkulimit mujor të interesit dhe tani nuk zgjat më shumë se 10 vite nga data e lindjes së detyrimit.
Zvogëlimi i viteve për dorëzimin e kërkesës për kreditim/rimbursim dhe numrit të ditëve për shqyrtim të kërkesës për rimbursim	Në ligjin paraprak kërkesa për rimbursim mund të dorëzohej për periudhën brenda 6 viteve nga data kur është paguar tatimi, ndërsa afati për shqyrtimin e kërkesës për rimbursim ishte 60 ditë.	Me ndryshimin e ligjit është zvogëluar në 3 vite periudha brenda të cilës dorëzohet kërkesa për kreditim/rimbursim si dhe është reduktuar numri i ditëve në 30 ditë kalderike për shqyrtimin e kërkesës për rimbursim, nga ATK.
Rregulla e re lidhur me barrën tatimore	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak	Me ligjin e ri është vendosur rregulla e re lidhur me barrën tatimore ku ATK ka të drejtë të vendos barrën tatimore në tërë pasurinë e personit, përfshirë edhe pasurinë e blerë nga personi pas vendosjes së barrës tatimore për ta siguruar obligimin tatimor.

Ndryshimet	Ligji paraprak	Ligji aktual
Themelimi i Bordit të Ankesave	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak.	Me këtë ligj do të themelohet Bordi i Ankesave i cili do shqyrtojë vendimet nga njësia e ankesave në lidhje me legjislacionin tatimor dhe doganor. Për më shumë koha e shqyrtimit të ankesave në këtë shkallë është 30 ditë, ku vendimet do jenë përfundimtare për sa i përket procedurës administrative.
<i>Ndryshimi i ndëshkimeve në lidhje me mos deklarim</i>	Ndëshkimi administrativ ka qenë 5% - 25% për muaj të obligimit tatimor.	Tani për raste kur ekziston një obligim tatimor dhe nuk është dorëzuar deklarata: - për personin fizik afarist gjoba do jetë 50€, për çdo deklaratë të pa deklaruar; - për personin juridik gjoba do jetë 150€ për çdo deklaratë të pa deklaruar; - për personin fizik jo afarist gjoba do jetë 20 €, për çdo deklaratë të pa deklaruar.
Gjobat lidhur me nën deklarin e tatimit dhe mbi deklarimin e rimbursimeve apo kreditimeve tatimore	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak.	Në ligjin e ri është shtuar dispozita e cila parasheh që në rastet kur ATK nga analiza e rrezikut identifikon se është nëndeklaruar qarkullimi atëherë aplikohet gjoba prej 25% e vlerës së nëndeklaruar.
Sanksionet për mos dorëzim, mos krijim ose mos paraqitje të të dhënave	Në ligjin paraprak gjoba për mos dorëzim të një pasqyre të informatave ishte 125€ për secilën pasqyrë të pa dorëzuar, deri në maksimum prej 2,500€. Në ligjin paraprak gjobat për mos mbajtje të regjistrimeve sipas legjislacionit, sipas kategorive në vijim ishin: - 125€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor deri 30,000€; - 250€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga 30,000€ deri në 200,000€; - 500€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga 200,000.01€ deri në 500,000€; - 1,000.00€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga 500,000€ e më shumë.	Në ligjin e ri gjoba për mos dorëzim të një pasqyre të informatave është 150€ për secilën pasqyrë të pa dorëzuar, deri në maksimum prej 3,000€. Po ashtu me ligjin e ri janë ndryshuar gjobat për mos mbajtje të regjistrimeve sipas legjislacionit, sipas kategorive në vijim: - 150€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor deri 30,000€; - 250€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga 30,000.01€ deri në 200,000€; - 500€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga 200,000.01€ deri në 500,000€; - 1,000.00€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga 500,000.01€ deri në 5,000,000€; dhe - 2,000€ për tatimpaguesin me qarkullim vjetor prej 5,000,000€ e më shumë. Për më shumë, me ndryshimin e fundit të ligjit është përfshirë dispozita ligjore e re e cila parasheh që çdo person i cili nuk përditëson informatat siç kërkohet me ligj, i nënshtrohet 150€.
Gjoba për punëdhënës lidhur me mos informimin e ATK për punëtorë të rinj	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak.	Me ligjin e ri është paraparë dispozita e re e cila parasheh që çdo punëdhënës, i cili nuk informon ATK për punëtorët e rinj i nënshtrohet një gjobe prej 500€ për secilin punëtor të padeklaruar
Gjobat lidhur me TVSh	Gjoba lidhur me TVSh në ligjin paraprak ishte në shumën prej 250€ për secilën shkelje.	Me ligjin e ri shuma e gjobës është zvogëluar në 150€ për secilën shkelje.
Gjoba për mallrat pa dokumentacion	Në rastet e posedimit të mallrave pa origjinë është aplikuar gjoba 25% e vlerës së tregut të mallrave	Në ligjin e ri përqindja e gjobës për posedim të mallrave pa origjinë është ngritur në 30% të vlerës së tregut të mallrave.
Zbritja e gjobave	Nuk ka qenë e paraparë në ligjin paraprak.	Me ndryshimet e fundit në ligj për administrimin e procedurave tatimore është përfshirë dispozita që mundëson zbritjen e gjobave në 50 % të vlerës së gjobës së aplikuar nëse paguhet brenda 15 ditë kalendarike.
Zvogëlimi i periudhës së shqyrtimit të ankesave	Numri i ditëve brenda të cilave është shqyrtuar nga ATK ankesa e tatimpaguesit ishte 60 ditë	Me ndryshimet në Ligj, është zvogëluar numri i ditëve brenda të cilave ATK do shqyrtojë ankesën e tatimpaguesit, ku tani është 45 ditë.

Ndryshimet e tjera:

- Është bërë grupizimi i llojeve të deklaratave tatimore;
- Është paraparë forma e dorëzimit elektronik të dokumenteve nga ATK për tatimpaguesin;
- Harmonizimi i përkufizimit të entitetit me përkufizimet në ligjet tjera tatimore;
- Përkufizimi i faturës fiktive;
- Përkufizimi i pasqyrës së informatave e cila bën që të dallohet nga deklarata tatimore;
- Përkufizimi i punëdhënësit dhe i të punësuarit;
- Janë përcaktuar rregullat e Shkëmbimit të informatave bazuar në marrëveshjet tatimore ndërkombëtaresi dhe bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare për shkëmbim të informatave;
- Me këtë ligj parashihet edhe mekanizmi - Marrëveshja Tatimore e cila mund të arrihet para seancës në bord, për të zgjidhur konfliktin mes tatimpagueit dhe ATK.

Nga ndryshimet e bëra së fundi në ligjin për administrimin e procedurave tatimore, synohet që tatimpaguesit të përfitojnë plotësisht nga teknologjia e informacionit, e cila do të mundësojë reduktimin e barrës dhe shpenzimeve dhe për ATK do të përmirësojë efektivitetin e kontrolleve tatimore.

Burimi: [link](#)

PwC Kosovo - Tax Alert

The Law on the Administration of Tax Procedures

On January 28, 2024, the Law on the Administration of Tax Procedures entered into force, which aims to regulate the procedures for the administration of tax obligations in the Republic of Kosovo that are within the scope of the Tax Administration of Kosovo (TAK), as well as the principles of organization and operation of TAK. Through this law, it is intended to provide a comprehensive framework for tax rules and procedures in Kosovo, adapting to the latest developments in the field of taxation and modern tools of communication, which together lead to a more advanced tax system.

The main changed topics from the previous law are summarized as follows:

Changes	Previous Law	Current Law
Definition of beneficial owner	The beneficial owner is considered to be the individual or legal entity that enjoys the benefits from an owned asset and that dominates and has control over an asset.	With the changes in the law, there has been added the case of a natural person, when effective control is exercised, and in the case of legal entities, it was added a threshold of 25% of the ownership interest. In addition, specific cases for beneficial owners have been added such as legal agreements, foundations, trusts, life insurance and business related investment insurance.
Expansion of the list of related persons	Related persons are considered to be: persons who are officials or business directors of each other, business partners, employer - employee, when he controls 50% or more of the shares or voting rights, the person who directly or indirectly controls the other person, the two persons are directly or indirectly controlled by a third person, the persons are spouses, relatives of the third generation, of the second generation of the husband or wife.	In addition to the previous law, the list of related persons has been added, also the case that a related person is considered to be each parent company, branch and sub-branch that are part of the multinational group.
Extension of residency criteria	The residence was defined where the place of residence was, or the presence is of 183 days; or place of establishment or place of effective management.	A natural person is considered to be a resident when the main place of residence is in Kosovo; or when he spends more than 183 days in Kosovo; or has the center of vital interests in Kosovo. As for legal entities, the establishment criterion has been removed and now it is only the effective place of management.
Expanding the understanding of open market value	Open market value is defined as the price that would be determined for similar goods/services in an impartial commercial transaction.	With the new law, there has been added the case when the open market value cannot be determined, where in relation to goods/services, the open market value will be the price not less than the purchase price or the cost price at the time of supply.
Shortening the days for deregistration of the taxpayer	Previously, the number of days for reviewing the request for deregistration by TAK was 60 days.	Now the number of days has been shortened which is 45 days.
New rule regarding record keeping	It was not foreseen in the previous law	In the new law, the rule has been added which gives TAK the right to determine the format of keeping records as well as the criteria that must be contained in the software used by businesses for wholesale and retail sales.

Changes	Previous Law	Current Law
New rule on record keeping by taxpayers	It was not foreseen in the previous law	The new law includes a new provision regarding the time that records must be kept for certain categories such as: - Assets that are depreciable for more than 6 years must be kept for the depreciable life of the assets, plus 1 year additional - records related to capital gains must be kept until such assets have been sold or exhibited plus 6 additional years - records related to long-term construction contracts must be kept plus 6 years from the completion of the project - records related to with electronic services must be kept for a period of at least 10 years after the end of the tax period when the electronic services were provided - records related to investable gold transactions must be kept for a period of at least 10 years.
Reducing the amount of B2B transactions	The amount of B2B transactions which was paid in cash was 500 EUR.	The amount of B2B transactions which is paid in cash has been reduced to 300 EUR, while for B2C transactions the amount remains to be determined by the Ministry of Finance.
New rules for employers regarding employees	It was not foreseen in the previous law	A new provision is included in the new law, which obliges that every salary paid to an employee be made through a licensed financial institution. In addition to this, there was introduced the provision which obliges every employer to inform TAK about the conclusion of a labor contract, one day before employee starts to work.
Sharing of data by commercial banks and notaries	It was not foreseen in the previous law	Now commercial banks and notaries are obliged to submit to TAK the data on local and international transactions of natural persons and legal persons on a monthly, quarterly basis or upon request.
Reduction of the period for correction of the tax declaration	The period for which the taxpayer could go back to correct the tax return was 6 years.	Now with the new law this period has been reduced to 3 years.
Limiting the time of interest calculation for non-fulfillment of obligations	In the previous law, the monthly calculation of interest continued until the date when the tax was paid.	According to the new law, the time of monthly interest calculation has been limited and now it does not last more than 10 years from the date when the obligation occurs.
Reducing the number of years for submitting the request for credit/refund and the number of days for reviewing the request for refund	In the previous law, the refund request could be submitted for the period within 6 years from the date when the tax was paid, while the deadline for reviewing the refund request was 60 days.	With the amendment of the law, the period within which the request for credit/refund is submitted has been reduced to 3 years, as well as the number of days has been reduced to 30 calendar days for reviewing the request for refund, by TAK.
The new rule regarding the tax lien	It was not foreseen in the previous law	With the new law, a new rule has been established regarding the tax lien where TAK has the right to impose the tax lien on the entire property of the person, including the property purchased by the person after the lien has been imposed to secure the tax obligation.
Establishment of the Appeals Board	It was not foreseen in the previous law	With this law, the Appeals Board will be established which will review the decisions from the appeals unit regarding the tax and customs legislation. Moreover, the time for reviewing appeals at this level is 30 days, where the decisions will be final in terms of the administrative procedure.

Changes	Previous Law	Current Law
Change of penalties related to non-declaration	The administrative penalty was 5% - 25% per month of the tax liability.	Now, for cases where there is a tax obligation and the declaration has not been submitted: - for the individual business, the fine will be €50, for each tax return that is not submitted; - for the legal entity, the fine will be €150 for each for each tax return that is not submitted; - for the non-business natural person, the fine will be €20, for each tax return that is not submitted.
Penalties related to under-declaration of tax and over-declaration of refunds or tax credits	It was not foreseen in the previous law.	In the new law, a provision has been added which foresees that in cases where TAK, from the risk analysis, identifies that the turnover has been under-declared, then a fine of 25% of the under-declared value is applied.
Sanctions for not submitting, not creating or not presenting data	In the previous law, the fine for not submitting a statement of information was €125 for each statement not submitted, up to a maximum of €2,500. In the previous law, the fines for not keeping records according to the legislation, as per following categories, were: - €125 for the taxpayer with an annual turnover of up to €30,000; - €250 for the taxpayer with annual turnover from €30,000 to €200,000; - €500 for taxpayers with annual turnover from €200,000.01 to €500,000; - €1,000.00 for taxpayers with an annual turnover of €500,000 or more.	In the new law, the fine for not submitting a statement of information is €150 for each statement not submitted, up to a maximum of €3,000. The new law also changed the fines for not keeping records according to the legislation, according to the following categories: - €150 for taxpayers with an annual turnover of up to €30,000; - €250 for taxpayers with annual turnover from €30,000.01 to €200,000; - €500 for taxpayers with annual turnover from €200,000.01 to €500,000; - €1,000.00 for the taxpayer with annual turnover from €500,000.01 to €5,000,000; and - €2,000 for the taxpayer with an annual turnover of €5,000,000 or more. Moreover, with the last amendment of the law, a new legal provision has been included, which stipulates that any person who does not update the information as required by law, is subject to a fine of €150.
Fines for employers related to not informing TAK about new employee	It was not foreseen in the previous law.	With the new law, a new provision foresees that any employer who does not inform TAK about new workers is subject to a fine of €500 for each undeclared worker
Fines related to VAT	The fine related to VAT in the previous law was in the amount of €250 for each violation.	With the new law, the amount of the fine has been reduced to €150 for each violation.
Fines for goods without documentation	In cases of possession of goods without origin, a fine of 25% of the market value of the goods has been applied	In the new law, the percentage of the fine for possession of goods without origin has been raised to 30% of the market value of the goods.
Reduction of fines	It was not foreseen in the previous law.	With the recent changes in the law on the administration of tax procedures, a provision has been included that enables the deduction of fines to 50% of the value of the applied fine if it is paid within 15 calendar days.
Reduction of the appeal review period	The number of days within which TAK reviewed the taxpayer's appeal was 60 days	With the changes in the Law, the number of days within which TAK will review the taxpayer's appeal has been reduced, where it is now 45 days.

Other changes:

- Grouping of types of tax declarations has been done;
- The form of electronic submission of documents by TAK for the taxpayer is foreseen;
- Harmonization of the definition of the entity with the definitions in other tax laws;
- Definition of fictitious invoice;
- Definition of the statement of information which makes it different from the tax return;
- Definition of employer and employee;
- Information exchange rules have been defined based on international tax agreements and based on international information exchange agreements;
- This law also foresees the mechanism - the Tax Agreement, which can be reached before the board session, to resolve the conflict between the taxpayer and TAK.

From the changes made recently in the law on the administration of tax procedures, it is intended that taxpayers will fully benefit from information technology, which will enable the reduction of burdens and expenses and for TAK will improve the effectiveness of tax controls.

Source: [link](#)



Let's talk!

PricewaterhouseCoopers Kosovo

Str. Mujo Ulqinaku No. 5 Apt. 10 Qyteza Pejton

Prishtina, Kosovo

Telephone: +383 38 722 555

Email: al_pwc_kosovo@pwc.com

Web: www.pwc.com/ks

